

LIGJ
Nr.9979, datë 8.9.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCEVE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, TË PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA FEDERALE E FINANCEVE, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, të përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave, për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5883, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I FINANCEVE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
AUSTRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI FEDERAL I FINANCEVE MBI
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, dhe Qeveria e Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, këtu të quajtura “Palët Kontraktuese”,

- me dëshirën për të nxitur më tej marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve të tyre;

- me dëshirën për të zhvilluar, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin e suksesshëm në fushën financiare,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Palët Kontraktuese përpiqen në kuadrin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave të tyre përkatëse në fuqi, si dhe të detyrimeve të tyre ndërkombëtare të nxisin dhe zgjerojnë bashkëpunimin financiar.

Neni 2

Për qëllimin e nxitjes dhe zgjerimit të bashkëpunimit financiar, Ministri Federal Austriak i Financave është i gatshëm të mbështesë dhënien e kredive të ndihmës me terma koncesionare, të rifinancuara nga Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (OeKB), Vjenë, në bazë të skemës së saj financiare të eksportit.

Një kuadër tregues financiar deri në 25 000 000 euro (njëzet e pesë milionë euro) parashikohet mbi një bazë përjashtimore për një periudhë deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Termat dhe kushtet e huave do të caktohen në pajtim me detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga “Masa për kreditë e eksportit të mbështetura zyrtarisht” nën kujdesin e OECD-së. Kështu, niveli i koncesionit do të jetë të paktën 35%.

Përshtatshmëria e projekteve që duhet të financohen do të vlerësohen duke marrë parasysh udhëzuesin *ex-ante* në bazë të disiplinave përkatëse të ndihmave “Helsinki”, si dhe të kriterëve të zbatueshme të brendshme të alokimit.

Neni 4

Marrëveshjet e huasë të rifinancuara nga OeKB-ja negociohen drejtpërdrejt ndërmjet bankave tregtare si huadhënës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Neni 5

Përfshirja e projekteve në këtë Marrëveshje do të miratohet nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale të Financave të Republikës së Austrisë. Ajo bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë periudhës 24-mujore, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Projektet në negociim e sipër para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mund të përfshihen.

Neni 6

Huatë e dhëna duhet të përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve austriake që mund të përbëjnë deri në 30% të mallrave dhe shërbimeve me origjinë jashtë Austrisë.

Neni 7

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, garanton në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushte përmbushjen e të gjitha pagesave që rrjedhin nga huatë koncesionare austriake të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga imuniteti ndaj padisë apo ekzekutimit për të cilin mund të ketë të drejtë në lidhje me pagesat e garantuara nga kjo Marrëveshje.

Neni 8

Të gjitha pagesat në lidhje me huatë koncesionare përjashtohen nga të gjitha taksat dhe tarifatat që caktohen nga Pala shqiptare.

Neni 9

Palët Kontraktuese në një bazë vjetore ose kurdoherë që mendohet e nevojshme nga Palët Kontraktuese rishikojnë progresin e bërë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Me qëllim që të vlerësohet përdorimi i huave të koncesionit të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe qëndrueshmëria e projekteve përkatëse, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë lehtëson nxjerrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e projekteve.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me pajtim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit pas muajit në të cilin Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën mbi përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në vendin e tyre përkatës. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë dyvjeçare.

Bërë në dy kopje origjinale, të dyja në gjuhën angleze.